



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KRYETARI**

Nr. 1245 / 11 prot.

Pogradec, më 11, 03, 2022

**Lënda:** Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**Z. SOTIRAQ MANGËRI**

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**I nderuar zoti Kryetar,**

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

**DHËNIEN E PËLQIMIT, PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE TË  
QYTETIT, NË FSHATIN GURAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE BUÇIMAS,  
BASHKIA POGRADEC”**

Me respekt,

**KRYETARI  
Ilir XHAKOLLI**



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1 (nje)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (dy)

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: \_\_\_\_\_





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KESHILLI

Nr. \_\_\_\_ prot.

Pogradec, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2022

**PROJEKT – VENDIM**

**NR. \_\_\_\_\_, DATË \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2022**  
**PËR**

**DHËNIEN E PËLQIMIT, PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE TË QYTETIT, NË FSHATIN GURAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE BUÇIMAS, BASHKIA POGRADEC.**

Në mbështetje të; Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pikat 1 dhe 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomisë vendore" të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", pikës 2 të nenit 8, pikën 1.2 të nenit 9, pikes 7 të nenit 23, shkronjës "k" dhe shkronjës "n" të nenit 54, të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", nenit 3 dhe nenit 8 të Ligjit Nr.9220, datë 15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit", i ndryshuar, Ligjit Nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes public", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.711, datë 29.10.2014, "Për miratimin e rregullores teknike "Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë", bazuar në relacioni i paraqitur dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI I BASHKISË**  
**VENDOSI :**

1. Të shprehë pëlqimin për shtimin e sipërfaqes në varrezat publike të qytetit, në fshatin Guras (Zagorçan), Njësia Administrative Buçimas, Bashkia Pogradec.
2. Bashkia Pogradec të marrë të gjitha masat për, hartimin e projektit përkatës në përputhje me dispozitat e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.711, datë 29.10.2014, "Për miratimin e rregullores teknike "Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë" dhe evidentimin e pasurive në të cilat do të shtohet sipërfaqja e varrezave publike.
3. Efektet: Garantimi i shërbimit të varrimit në qytetin e Pogradecit.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe administrata e Bashkisë Pogradec.
5. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.
6. U shpall sot më datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2021.

**KRYETAR**  
**SOTIRAQ MANGËRI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE DHE ÇËSHTJEVE JURIDIKE  
SEKTORI MONITORIMIT KONTRATAVE, EVIDENTIMIT DHE INVENTARIZIMIT TE ASETETEVE

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Pogradec, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2022.

**Relacion**

**PËR**

**DHËNIEN E PËLQIMIT, PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE TË QYTETIT, NË FSHATIN GURAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE BUÇIMAS, BASHKIA POGRADEC.**

Të nderuar!

Në mbështetje të; Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pikat 1 dhe 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomisë vendore" të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", pikës 2 të nenit 8, pikën 1.2 të nenit 9, pikes 7 të nenit 23, shkronjës "k" dhe shkronjës "n" të nenit 54, të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.8480, date 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale te administrates shtetore dhe enteve publike", nenit 3 dhe nenit 8 të Ligjit Nr.9220, datë 15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit", i ndryshuar, Ligjit Nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes public", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.711, datë 29.10.2014, "Për miratimin e rregullores teknike "Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë", bazuar në udhërdhërat dhe detyrat e percaktuara në rregulloren e Bashkise Pogradec Drejtoria Juridike dhe sektori i monitorimit te kontratave evidentimit dhe inventarizimit te aseteteve ne bashkepunimin me Drejtorine e planifikimit dhe zhvillimit te teritorit kane bere evidentimin dhe sakesimin e vendit dhe pronesise ku kerkohen te zgjerohen varrezat e Qytetit.

Duke marre per baze se ne Varrezat e Qytetit nuk ka me hapësira per te kryer varrime si dhe nuk ka mundesi per zgjerim te tyre mori ne konsiderate se ne varrezat e reja te ngritura ne vendin e quajtur "KRESNJAK" qe ben pjese afer Fshatit Guras dhe pronat shtrihen ne Zonen Kadastrale Guras dhe Geshtenjas, u be evidentimi i pronareve te paisur me dokumentacion pronareve pretendues dhe pronave shtet per kete specialistet perkates te sektoreve respektive bene verifikimin ne vend me dokumentacion dhe grumbulluan kpje te dokumentacionit qe ata zoteronin.

Me kokretisht pronat ku kerkohet zgjerimi i varrezave shtrihen ne pasurine 321 e ndare ne 25 pasuri te zones kadastrale 1711 Geshtenjas e cila ka ne total nje siperfaqe prej 119965 m2 ose 11.9 Ha ne te cilen ben pjese edhe parcelat ku jane varrezat ekzistuese me siperfaqe 7435 m2, pasurine 319 e ndare ne dy pasuri te zones kadastrale 1903 Guras dhe ka siperfaqe afer 3600 m2 dhe pasuria 173/1 me siperfaqe 4000 m2 gjithsej siperfaqja qe kerkojme per zgjerim ne te tre pasurite do te jete 120130 m2 ose 12.0130 Ha ( Dymbedhjete hektare e njeqind e tridhjete e pese metra).

<sup>1</sup>Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: [bashkiapogradec@gmail.com](mailto:bashkiapogradec@gmail.com)



Ne lidhje me pronesine sqarojme se:

Ne Pasurine 321 jane 25 pasuri nga te cilat:

A- 4 pasuri me siperfaqe 7435 m2 jane shpronesuar ne vitin 2010 perkatesisht pasurite:

1- 321/1 me siperfaqe 1990 m2 ne pronesi shtetasit Nezhdet Mehmet Capo.

2- 321/2 me siperfaqe 2020 m2 ne pronesi Enver Hasan Llangozi.

3- 321/3 me siperfaqe 1845 m2 ne pronesi Seladin Neki Purba.

4- 321/4 me siperfaqe 1600 m2 ne pronesi Xhevit Dilaver Elmasllari (pretendon nuk eshte bere shpronesimi)

B- 9(Nente) pasuri me siperfaqe 16840 m2 jane me pronar dhe duhen shpronesuar perkatesisht:

1-321/20 me siperfaqe 800 m2 ne pronesi me certifikate Seladin Neki Purba.

2- 321/21 me siperfaqe 1090 m2 ne pronesi me certifikate Enver Fazlli Capo.

3-321/6 me siperfaqe 1000 m2 ne pronesi me certifikate Safet Kamber Manellari.

4-321/25 me siperfaqe 3700 m2 ne pronesi bashkepronareve Lefter Sulkollari etj me cetifikate.

5-321/9 me siperfaqe 2450 m2 ne pronesi bashkepronareve minir manellari etj me certifikate.

6- 321/11 me siperfaqe 1300 m2 ne pronesi me certifikate Gafer Ramadan Yzellari.

7-321/12 me siperfaqe 1440 m2 ne pronesi me (AMTP) Arefi Idriz Yzellari.

8-321/15 me siperfaqe 2660 m2 ne pronesi me certifikate Avni Dilaver Hysenllari.

9-321/16 me siperfaqe 2400 m2 ne pronesi me certifikate Zafir Xhezmir Zacellari.

C- Nga pasuria 321 ngelen shtet dhe nuk kerkohet shpronesim duke mos parashikuar ndonje AMTP te leshuar por qe nuk na eshte paraqitur apo nuk ka kerkuar regjistrimin e saj ne ASHK Pogradec siperfaqja 95690 m2 ose 9.569 Ha eshte pronesi shtet.

Si perfundim per shpronesim me dokumentacionin e tanishem duke zbritur shpronesimet e vitit 2010 relatohet ne keshill qe kosto per shpronesimin e zgjerimit te varrezave te qyteti prane varrezave eksistuese do te jete e barabarte me shpronesimin e siperfaqeve respektive sipas parcelave jepet ne tabelen me poshte:

| Nr | Pasuria qe Preket | Siperfaqja ne m2 |
|----|-------------------|------------------|
| 1  | 321               | 16840            |
| 2  | 319               | 3600             |
| 3  | 173               | 4000             |
|    | SHUMA             | 24440            |

Ose thene ne Hektare 2.4440 ( Dy hektare dhe katermije e katerqind e dyzete metra) me proces qe merret komisioni i posacem i ngritur me urdherin e Kryetarit te Bashkise.

Sqarojme Pasurite 319 dhe 173 do perfshihen ne listen per shpronesim mbasi ne projektin teknik te Drejtorise se urbanistikes jane parashikuar edhe vende parkimi ku mjetet do te qendrojne kur te shkojne ne ceremonite e varrimit mbasi vendi dhe pozicjoni kushtezon keto masa.

Për sa më sipër mbasi kemi dhene informacionin e nevojshem si dhe dokumentacionin teknik te kerkuar , po ju paraqisim kërkesën për miratim në Këshillin Bashkiak.

Bashkëlidhur po ju paraqisim Projekt – Vendimin dhe dokumentacionin përkatës për miratim në Këshillin Bashkiak.

Ju faleminderit!

Konceptoi: Dritan DIKELLARI

Namir ÇELA

Konfirmoi: Nexhmi TORRA

**KRYETAR  
ILIR XHAKOLLI**

